



ANALIZA

**MBI TREGUESIT E PUNËS TË PROKURORISË
PRANË GJYKATËS SË APELIT KORÇË
PËR VITIN 2018**

**PROKURORIA E APELIT
KORÇË**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE APELIT
KORÇË

R A P O R T
MBI VEPRIMTARINE E PROKURORISE SE APELIT KORÇE
PER PERIUDHEN 1 JANAR 2018 - 31 DHJETOR 2018

Znj. ARTA MARKU
PROKUROR I PERGJITHSHEM I REPUBLIKES

PROKURORIA E PERGJITHSHME
T I R A N E

Veprimtaria e Prokurorise se Apelit Korçe, per vitin 2018 si objekt analize, eshte realizuar ne ushtrimin e funksionit te saj ne respektim te Kushtetutes, Ligjit procedural dhe material penal, Kodit te Drejtesise Penale per te Mitur, si dhe te konventave nderkombetare.

Ne kuadrin ligjor te reformes ne drejtesi, vemendja eshte fokusuar ne ndeshkimin e fenomeneve shqetesuese per shoqerine shqiptare qe pengojne integrimin ne Bashkimin European dhe ne funksion te ketij qellimi, kemi synuar ne menyre te vazhdueshme rritjen e standarteve te gjykimit me nje perfaqesim cilesor dhe korrekt te prokurorit, duke mbajtur ne konsiderate maksimale zbatimin e Rekomandimeve Prioritare te Keshillit te Ministrave ne luften kunder kriminalitetit, zbatimin e Udhhezimeve te Pergjithshme te Prokurorit te Pergjithshem, si dhe te Rezolutes se Kuvendit dhe Planit te Veprimit ne zbatim te saj.

Ne kete konteks, Prokuroria prane Gjykates se Apelit Korçe me juridiksion te pergjithshem ka qene ne koherence te plote te kerkesave te kohes dhe kjo materializohet me se miri ne qendrimet qe ka mbajtur, per vete specifikën e veprimtarise se prokurorit te Apelit, si prokurori gjyqesore, e cila lidhet me nje hetim paraprak te kryer nga Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare, por dhe me nje gjykim te kryer dhe vendim te Gjykates.

Ne analizen me poshte, do te perqendrohem ne probleme te rendesishme qe lidhen jo vetem me qendrimin e prokurorit te Apelit ne raport me kerkimet e bera nga prokuroret e shkalles se pare dhe qendrimin e gjykates, si edhe problemet e hetimit dhe gjykimit qe jane evidentuar gjate ketij viti me qellim permiresimin.

Ndryshimet ne Kodin e Procedures Penale kane dhene efekt ne funksionimin e organit te prokurorise dhe te Gjykates se Apelit. Gjithsesi, ndryshimet ligjore kerkojne nje njohje dhe zbatim korrekt duke filluar nga hetimi paraprak, gjykimi ne seancen paraprake, gjykimi ne themel, por edhe gjykimi ne Gjykatën e Apelit.

Ne vazhdim te ketij raportimi, fillimisht do te japim nje paraqitje me shifra te volumit te çështjeve te perfaqesuara nga Prokuroria e Apelit Korçe, per vitin 2018 dhe me pas disa probleme qe kane dale gjate gjykimit dhe shqyrtimit te çështjeve.

Volumi i çështjeve ne teresi te ndjekura nga Prokuroria e Apelit Korçe eshte si me poshte :

Per vitin 2018, ne Prokurorine e Apelit Korçe jane regjistruar gjithsej 545 çështje nga te cilat 522 çështje te reja dhe 23 te mbartura nga viti 2017.

Ne Gjykatën e Apelit Korçe per vitin 2018, jane perfunduar 509 çështje penale me pjesemarrjen e prokurorit te Apelit nga te cilat, 247 çështje themeli, 90 çështje te veçanta, 158 masa sigurimi dhe 14 shuarje mase. Ndersa jane mbartur per vitin 2019, 36 çështje ku 23 jane çështje themeli, 1 mase sigurimi dhe 12 çështje jane te veçanta.

Çështjet e themelit jane shqyrtuar ne 42 raste mbi apelin e prokurorit dhe ne 205 raste mbi apelin e te pandehurit (*sqaroj se ne te dhenat statistikore apelet e ushtruar nga te pandehurit perfaqesojne nje numer me te madh, 211 apele te te pandehurve, pasi kjo e dhene korrespondon me numrin e te pandehurve qe kane ushtruar te drejten e ankimit dhe jo me numrin e çështjeve ne total, per faktin se ne nje çështje rezulton te kete bere apel me shume se nje i pandehur*).

Volumi i çështjeve te ndara sipas prokurorive qe jane ne juridiksionin e Prokurorise se Apelit Korçe :

Per Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Korçe jane shqyrtuar 196 çështje themeli nga te cilat 36 çështje mbi apelin e prokurorit dhe 160 raste mbi apelin e te pandehurit

Per Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Pogradec jane shqyrtuar 51 çështje themeli nga te cilat, 6 raste mbi apelin e prokurorit dhe 45 raste mbi apelin e te pandehurit.

Ne te dhenat statistikore nuk perfshihen 90 çështje te perfunduara, te cilat ne i kategorizojme te veçanta, pasi kjo kategori nuk eshte e parashikuar

ne formularet e miratuar. Keto lloj çeshtjesh zene nje perqindje te konsiderueshme ne veprimtarine e Prokurorise se Apelit Korçe dhe qe shpesh lidhen me problematike delikate, siç jane ankimet ne lidhje me vendime mosfillimi, ne fazen e ekzekutimit te vendimit penal, çeshtjet me akuze private nga viktimat akuzuese etj, te cilat shqyrtohen mbi apelin e paleve ne proces dhe nuk mund te neglizhohen dhe te mos jene ne dijeni te Drejtorise se Studimit prane Prokurorise se Pergjithshme.

Ne Prokurorine e Apelit Korçe ushtrojne funksionin dy prokurore, ngarkesa e çeshtjeve per secilen prokurore eshte si me poshte:

Prokurore Irma Balli, me cilesine e Drejtuesit te Prokurorise se Apelit Korçe ka perfaqesuar dhe perfunduar :

- 133 çeshtje themeli.
- 76 masa sigurimi.
- 37 çeshtje te tjera te kategorizuara te veçanta.
- Ka te mbartura 10 çeshtje per vitin 2019.
- Ka ushtruar 22 rekurse.
- Ka urdheruar 27 ekzekutime vendimi.

Po keshtu, ka ndjekur veprimtarine e prokurorise me cilesine e drejtueses bazuar ne ligjin "Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne Republiken e Shqiperise".

Prokurore Rozeta Qirjaqi ka perfaqesuar dhe perfunduar :

- 114 çeshtje themeli.
- 82 masa sigurimi.
- 53 çeshtje te veçanta.
- Ka te mbartura 27 çeshtje per vitin 2019.
- Ka ushtruar 29 rekurse.
- Ka urdheruar 19 ekzekutime vendimi.

Duke krahasuar numrin e pergjithshem te çeshtjeve te regjistruara ne vitin 2018, me çeshtjet e regjistruara per vitin 2017 rezulton se ka nje ulje prej 94 çeshtjesh (*ka qene 639 numri i pergjithshem i çeshtjeve vitin e kaluar*). Me poshte, po japim nje pasqyre me te hollesishme te shqyrtimit te çeshtjeve ne Gjykatën e Apelit, shkaqet e apelimave te bera, perkrahjes se tyre dhe menyres se perfundimit ne Gjykatën e Apelit.

Per çeshtjet e themelit sqarojme si me poshte:

Ne 24 çeshtje, per te cilat eshte kerkuar mospranim ankimi, nga gjykata eshte vendosur me 24 vendime mospranim ankimi.

Ne 160 raste, per te cilat eshte kerkuar nga prokurori i Apelit lenie ne fuqi te vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare, nga gjykata ne 121 vendime eshte vendosur lenie ne fuqi, ne 30 raste eshte lehtesuar pozita e te pandehurit dhe ne 7 raste eshte pushuar çeshtja apo eshte dhene pafajesi dhe ne 2 raste eshte prishur vendimi dhe kthyer çeshtja per rigjykim.

Ne 29 raste, kur eshte kerkuar rendimi i pozites se te pandehurit, gjykata ne 17 raste ka vendosur lenie ne fuqi, ne 7 raste gjykata ka renduar poziten sipas kerkimit te prokurorit te Apelit, ndersa ne 3 raste gjykata ka lehtesuar poziten e te pandehurit, ne 1 rast ka prishur vendimin duke pushuar çeshtjen dhe ne 1 rast eshte vendosur prishje e vendimit dhe kthimi i çeshtjes per rigjykim.

Ne 25 raste, nga prokurori i Apelit eshte kerkuar lehtesim i pozites i te pandehurit dhe nga Gjykata e Apelit ne 23 raste eshte lehtesuar pozita e te pandehurit, ne 1 rast eshte vendosur lenie ne fuqi, ndersa ne 1 rast eshte prishur vendimi dhe pushuar çeshtja.

Ne 3 raste, eshte kerkuar nga prokurori i apelit prishje dhe pushim çeshtje dhe ne 3 raste gjykata ka vendosur prishje vendimi dhe pushimin e çeshtjes qe lidhen me vepra penale qe ndiqen mbi ankimin e viktimes ne kuptim te nenit 284 te K.Pr.Penale, ku viktimat ka hequr dore nga ankimi.

Ne 6 raste, eshte kerkuar prishje vendimi dhe kthimi i akteve per rigjykim, ku nga gjykata ne 4 raste eshte vendosur prishje vendimi dhe kthimi i çeshtjes per rigjykim, ne 1 çeshtje eshte vendosur lenie ne fuqi te vendimit dhe ne 1 rast eshte vendosur nga gjykata, prishje vendimi dhe pushim çeshtje.

I.Lidhur me apelet e ushtruara nga Prokuroria e Shkalles se Pare:

Per kete vit, jane ushtruar gjithesej 42 apele, nga 72 te ushtruara vitin e kaluar. Nga keto, 20 apele nga prokuroret jane ushtruar per mase te bute denimi dhe kryesisht per menyren e ekzekutimit te denimit me burgim ne lidhje me aplikimin e nenit 59 te K.Penal, 16 apele per pafajesi te dhena nga Gjykata e Shkalles se Pare dhe 6 apele per ndryshim te kualifikimit ligjor te vepres penale.

Apele te ushtruara nga prokuroria per vendime pafajsie:

Nga Prokurorite prane Gjykates se Shkalles se Pare jane ushtruar 16 apele, per vendim pafajesie nga te cilat :

Ne 4 raste, Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin me deklarim fajesie te te pandehurve, sipas kerkimit te prokurorit te Apelit. Çeshtjet iu perkasin te pandehurit Muharrem Çoçka, akuzuar per vepren penale "Korrupsion aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike" dhe "Largimi i te burgosurit nga vendi i qendrimit" parashikuar nga nenet 244 dhe 323/1 te K.Penal; te pandehurit Klement Kaçolli, akuzuar per vepren

penale “Vrasje me dashje” dhe “Prodhim dhe mbajtje pa leje te armeve luftarake dhe municionit” parashikuar nga nenet 76 e 278/2 te K.Penal; te pandehurit Arb Bashaj, akuzuar per vepren penale “Ogranizimi i llotarive te palejuara”, parashikuar nga neni 197 i K.Penal; te pandehurve Kejvi Shkambi etj, akuzuar per vepren penale “Shkelja e rregullave mbi lendet plasese”, parashikuar nga neni 282 i K.Penal.

Ne 2 raste eshte pranuar apeli i prokurorit, por eshte vendosur prishje e vendimit dhe kthim i ceshtjes per rigjykim, ne Gjykatën e Shkalles se Pare, pasi jane konstatuar shkelje me pasoje pavlefshmeri vendimi.

Ne 3 raste, eshte hequr dore nga apeli i prokurorit dhe i perket ceshtjes penale me te pandehur Fatmir Drazhi, akuzuar per vepren penale “Mashtrimi ne sigurime”, parashikuar nga neni 145 i K.Penal; me te pandehur Agron Kumani akuzuar per vepren penale “Veprime ne kundërshtim me vendimin e gjykates”, parashikuar nga neni 321/2 i K.Penal dhe me te pandehur Altjon Metollari, akuzuar per vepren penale “Kalim i paligjshem i kufirit shteteror”, parashikuar nga neni 297 i K.Penal.

Ne 7 raste, Gjykata e Apelit ka lene ne fuqi vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare.

Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane pranuar nga gjykata dhe kane qene shkaqet ligjore te parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, eshte ushtruar rekurs ne Gjykatën e Larte me qellim njehesimin dhe zhvillimin e praktikes gjyqesore.

Apele te ushtruara nga prokuroria, per vendime me ndryshim te kualifikimit ligjor te vepres penale.

Jane ushtruar 6 apele, per ndryshim te kualifikimit ligjor te vepres penale nga te cilat :

Ne 2 raste eshte ndryshuar vendimi sipas kerkimit te bere nga prokurori i Apelit me rendim te pozites te te pandehurve dhe i perkasin ceshtjeve me te pandehur Ligor Biba, akuzuar per vepren penale “Marredhenie seksuale ose homoseksuale me dhune me te mitur te moshes 14-18 vjeç”, parashikuar nga neni 101/1 i K.Penal, si dhe me te pandehur Janaq Qirici etj, akuzuar per vepren penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve” parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal, per te cilin Gjykata e Apelit ka disponuar prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve per rigjykim, pasi jane konstatuar shkelje me pasoje pavlefshmeri vendimi.

Ne 3 raste, Gjykata e Apelit ka lene ne fuqi vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare.

Ne 1 rast, Gjykata e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit dhe pushimin e ceshtjes, me te pandehur Marsela Toshi, akuzuar per vepren penale “Braktisja e femijeve te mitur”, parashikuar nga neni 124/2 i K.Penal.

Per te gjitha çeshtjet qe nuk jane pranuar nga Gjykata e Apelit dhe kane qene shkaqet ligjore te parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, me qellim njehesimin dhe zhvillimin e praktikes gjyqesore, eshte ushtruar rekurs ne Gjykatën e Lartë.

Apele te ushtruara nga prokuroria, per mase denimi te bute dhe zbatimin e alternativave te denimit me burgim.

Apelet e prokurorit me kete objekt jane ushtruar kryesisht per te ndryshuar menyren e ekzekutimit te vendimit te denimit me burgim lidhur me aplikimin e denimeve alternative dhe per masen e denimit qe ka qene relativisht e ulet.

Jane ushtruar 20 apele te prokurorit, per te ndryshuar masen e denimit, shumica jane te lidhura me alternativat e denimit me burgim.

Ne 2 raste, eshte ndryshuar vendimi duke u ashpersuar masa e denimit, dhene nga Gjykata e Shkalles se Pare, ne lidhje me llojin e denimit dhe mosaplikimin e nenit 59 te K.Penal per shkak se autoret kane qene perserites ne krim.

Ne 1 rast eshte ndryshuar vendimi duke pranuar kerkimin e prokurorit per prishjen dhe kthimin e akteve per rigjykim.

Ne 3 raste, eshte hequr dore nga apeli i prokurorit duke u vendosur mospranim i ankimit, ku per 2 çeshtje heqja dore nga apeli eshte bere per rastet e aplikimit te nenit 59 te K.Penal dhe per vepra te lehta, pasi kane ekzistuar kushtet dhe kriteret ligjore per zbatimin e kesaj alternative denimi dhe ne 1 rast eshte hequr dore nga apeli, pasi ishte ushtruar nga Drejtuesi i prokurorise, i cili sipas ndryshimeve te Kodit te Procedures Penale nuk legjitimohej te ushtronte apel.

Ne 1 rast, duke qene se vendimi ishte apeluar nga dy palet ne proces, gjykata ka lehtesuar poziten e te pandehurit.

Ne 13 raste, eshte lene ne fuqi vendimi i Gjykates se Shkalles se Pare, i apeluar nga prokurori per mase denimi dhe aplikimin e nenit 59 te K.Penal.

Ne pergjithesi, ato kane qene te lidhura me kryerjen e veprave penale te parashikuara nga nenet 144/a, 186/2, 199/a/2, 244, 298/3 te K.Penal dhe prokuroria e ka mbeshtetur denimin me burgim per te qene koherente me politiken e ashpër te denimit ne zbatim dhe te rekomandimeve te Keshillit te Ministrave.

Ne te gjitha çeshtjet, kur kane qene shkaqet ligjore te parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale eshte ushtruar rekurs ne Gjykatën e Lartë.

Lehtesim i pozites se te pandehurit vendosur nga gjykata:

Ne 121 çeshtje te apeluara nga te pandehurit, Gjukata e Apelit ka disponuar me lenie ne fuqi te vendimit te Gjukates se shkalles se pare duke rrezuar kerkimin e te pandehurit.

Ne 37 raste Gjukata e Apelit ka vendosur lehtesim te pozites, me zbutje denimi ne 30 raste. Ne 7 raste, nga Gjukata e Apelit eshte ndryshuar vendimi dhe eshte dhene pafajesi ose pushuar çeshtja .

Ne 2 raste (çeshtjet te shqyrtuara mbi apelin e te pandehurit) nga prokurori i Apelit, per shkelje te ligjit procedural penal, me pasoje pavlefshmeri vendimi apo mosarsyetim vendimi nga Gjukatat e Rrethit Gjyqesor, eshte kerkuar prishje vendimi e kthim çeshtje per rigjykim. Ne pergjithesi, ato lidhen me çeshtje te shqyrtuara ne Gjukaten e Apelit, mbi apelin e prokurorit.

Ne rast se shihet pasqyra e çeshtjeve (sipas pasqyrave te statistikes), per kete ndryshim zbutja e denimit lidhet me kryerjen e vepres penale te drejtimit te automjetit ne menyre te parregullt, shkelja e rregullave te qarkullimit rrugor, falsifikimi pasaportave, pengime ne ekzekutimin e vendimit te gjukates, ku eshte vendosur aplikimi i nenit 59 te K.Penal.

Nga Prokuroria e Apelit Korçe, eshte ushtruar rekurs ne te gjitha rastet kur eshte vleresuar zbatimi i gabuar i ligjit material apo procedural penal, nga ana e Gjukates.

Nga 25 raste, ne 23 prej tyre eshte pranuar kerkesa e prokurorit per zbutje te denimit qe lidhen me vepra penale te lehta dhe kur kane qene kushtet per aplikimin e nenit 59 apo 63 te K.Penal dhe veçanerisht per aplikimin e nenit 53/a te K.Penal, zevendesimin e denimit me burgim me nje shume te hollash ne favor te shtetit si nje nga alternativat specifike te denimit me burgim. Po keshtu, lehtesimi i pozites lidhet dhe me rastet kur te pandehur jane femra apo te mitur ne konflikt me ligjin.

Gjate shqyrtimit te çeshtjeve te themelit, Prokuroria e Apelit Korçe ka pasur pikesynim paraqitjen me cilesi te konkluzioneve, si ne rastet kur eshte kerkuar lenie ne fuqi te vendimit, por sidomos ne çeshtjet ku eshte dhene pafajesi dhe eshte argumentuar e kunderta, apo edhe ne rastet kur eshte kerkuar ndryshim i kualifikimit ligjor. Konkluzioni eshte se ne pergjithesi, apelet e ushtruara nga Prokurorite e Shkalles se Pare kane qene ligjore dhe jane mbeshtetur nga ana jone, por ka vend per permiresim. Shpesh here, apelet jane bere objekt i diskutimit me prokuroret per menyren e formulimit, shkaqet e ankimit ne kundershkim te vendimit objekt ankimi, si dhe per te plotesuar apelin sipas nenit 415 te K.Pr.Penale, sepse konstatohet qe apeli ushtrohet nga prokuroret pa u njohur me arsyetimin e vendimit nga Gjukata e Shkalles se Pare. Plotesimi i kesaj kerkese behet imediate me ndryshimet ne Kodin e Procedures Penale dhe pikerisht neni 425 i K.Pr.Penale, mbi “Kufijte e

shqyrtimit të çështjes”, që do të thotë se Gjykata e Apelit shqyrton çështjen mbi shkaqet e ngritura në apel. Vlen të përmendet se nuk konstatohet ushtrimi i apeleve kundërshtuese nga prokurorët në referim të nenit 423 të K.Pr.Penale.

Në këndvështrimin e ndryshimeve procedurale një problematike e hasur gjatë gjykimit në Apel është shqyrtimi i vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë, me deklaramë të pafajshëm të të pandehurve, ku prokurori detyrimisht kërkon çeljen e shqyrtimit gjyqësor, sepse nuk mund të pretendojë ndryshim vendimi mbi të njëjtat prova mbi të cilat është vendosur nga gjykimi në Gjykatën e Shkallës së Parë. Shqyrtimi gjyqësor bazuar në nenin 427 të K.Pr.Penale është domosdoshmëri që në fakt Gjykata e Apelit, nuk e aplikon sidomos në gjykimet e zhvilluara sipas institutit të gjykimit të shkurtuar, duke krijuar standart të dyfishtë në lidhje me kërkimin e prokurorit për perseritje të shqyrtimit gjyqësor, rastë të cilat janë bërë objekt rekursi.

Bazuar në rekomandimet e Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm konstatohen kërkesa të pakta të prokurorisë për gjykime të drejtperdrejta, sidomos për çështjet ku hetimi përfundon brenda kohës së “arrestit në flagrancë” dhe lidhet me çështje fakti, apo gjykimi me marrëveshje dhe urdhri penal si institute të reja në procesin penal.

Prokurorët e Apelit kanë respektuar afatet ligjore të gjykimit të çështjes duke mos u bërë pengesë në asnjë rast, për shtyrjen e procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit .

Apelet e ushtruara nga ana e prokurorisë për masën e denimit dhe që lidhen me vepra të rëndë penale të : korrupsionit, krimit ekonomik e financiar, trafikimit të narkotikëve, të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarakë, veprat penale kundër mjedisit dhe ndërtimit të paligjshëm; kanë qenë të bazuara dhe janë mbështetur nga prokuroria, por një pjesë e apeleve e sidomos për aplikimin e alternativave të denimit me burgim janë të tepruara, sidomos për persona jo problematike që kryejnë vepra të lehta për herë të parë, që janë të parëzikuara për shoqërinë dhe për shkak të ekzistencës së nevojave të posaçme ndaj tyre janë aplikuar alternativa të denimit, siç janë venia në provë, neni 59 i K.Penal apo puna në interes publik, neni 63 i K.Penal, si dhe zëvendësimi i denimit me burgim me një shumë të hollash në favor të shtetit, neni 53/a i K.Penal. Aplikimi i alternativave të denimit duhet parë me përparësi kur janë kushtet. Kjo vjen edhe si kërkesë e kohës së Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, që orienton se: ***Zbatimi i masave alternative të denimit, ndaj personave me rrezikshmëri të ulët shoqërore, që kryejnë vepra penale me masë denimi në maksimum deri 5 vjet burgim, por edhe e standarteve të referuara. Me këtë rast citoj: Sipas standarteve nderkombetare përdorimi i burgimit si formë denimi duhet kufizuar rreptësisht dhe të jetë extrema ratio, në rastë të veçanta atëherë kur nuk***

mund te zbatohen masa te tjera te pershtateshme. Siç shprehet Keshilli i Evropes, burgimi duhet te zbatohet si mase vetem kur çdo mase apo sanksion tjeter do te ishin te papershtateshme, per rendesine e vepres dhe duhet te behen perpjekje qe te minimizohet perdorimi i masave qe privojne personin nga liria dhe te zbatohen me shume ato te cilat nuk e bejne kete.

Ndryshe trajtohen personat shoqerisht te rrezikshem, perserites ne krim apo persona qe kryejne vepra penale per te cilat shoqeria eshte e ndjeshme (duke permendur dhunen ne familje, vrasjet, veprat penale qe lidhen me trafikimit e lendeve narkotike, trafikimi i qenieve njerezore, korrupsioni, krimi ekonomik etj). Apelet e ushtruara nga prokuroret mbeshteten, por edhe ne rastet kur nga gjykata eshte lehtesuar pozita e te pandehurit me ulje te denimit eshte ushtruar rekurs ne Gjykatën e Larte. Ne kete aspekt, denimi behet çeshtje kur subjekti eshte i mitur. Kodi i Drejtesise Penale per te Miturit ka sjelle ndryshime, ne te cilet vec faktorit prokurori dhe gjykate, kerkon pranine e aktoreve te tjere ne sherbim te dhenies se drejtesise apo dhe interesit me te larte te femijes, duke respektuar te drejtat procedurale te te miturit viktime, te miturit ne konflikt me ligjin dhe te miturit deshmitar.

II. Per çeshtjet e kategorizuara te veçanta rezulton se :

Jane perfunduar 90 çeshtje te kategorizuara te veçanta ku perfshihen çeshtje penale me objekt vendimi mosfillimi, lirim me kusht, çeshtje qe lidhen me fazen e ekzekutimit te vendimit, si dhe çeshtjet me viktime akuzuese.

Ne keto lloj gjykimesh, sidomos ne ato çeshtje qe lidhen me vendimet e pushimit, ku hetimi paraprak kontrollohet nga gjykata, me ndryshimet procedurale ne Gjykatën e Apelit zgjidhen ne dhomen e keshillimit.

Ne çeshtjet me objekt ankim vendim mosfillimi kemi vleresuar shkaqet ligjore nese duhet te vendoset regjistrimi i procedimit penal nga prokurori apo jemi para kushteve ligjore te mosfillimit te procedimit ne kuptim te nenit 290 te K.Pr.Penale. Gjithashtu jane kontrolluar vendimet e mosfillimit ne respektim te afateve ligjore detyruese te percaktuar ne K.Pr.Penale qe lidhen me marrjen e vendimit te mosfillimit nga prokurori, njoftimin e personave qe legjitimohen te ushtrojne te drejten e ankimit dhe afatin e tij.

Çeshtjet qe lidhen me viktimen akuzuese, procesi eshte orientuar sipas nenit 59 te K.Pr.Penale dhe prokurori ka ushtruar funksionin brenda kufijve te parashikuara nga kjo dispozite, por gjithmone me nje rol aktiv ne respektim te parimit te ligjshmerise per te dhene mendim, lidhur me fajesine e te akuzuarit, ne vleresimin e provave te paraqitura nga palet ne proces, apo dhe ne dhenien e mendimit per masen e denimit.

Çeshtjet me objekt “Lirim me kusht”, bazuar ne nenin 64 te K.Penal, jane te shpeshta ne Gjykatën e Apelit, kryesisht te apeluara nga te denuarit. Ne kete lloj gjykimesh, prokuroret jane treguar te kujdesshem jo vetem ne respektim te kerkesave te nenit 64 te K.Penal, por edhe ne respektim te vendimit unifikues Nr.2, Date 25.05.2015 te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte te vendosur per kete objekt. Per rastet kur Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare ne zbatim te gabuar te ligjit, nga ana jone eshte ushtruar rekurs.

III. Çeshtjet me objekt caktim mase sigurimi.

Viti qe analizohet ka pasur nje ulje te shqyrtimit te masave te sigurimit. Kete vit, jane regjistruar 158 masa sigurimi, nga 164 qe jane regjistruar vitin e kaluar.

Jane shqyrtuar dhe perfunduar gjithesej 158 masa sigurimi.

Masat e sigurimit ne 12 raste, jane shqyrtuar mbi apelin e prokurorit dhe ne 146 raste mbi apelin e personave nen hetim.

Ne 8 raste eshte kerkuar nga prokurori i Apelit ndryshim te mases se sigurimit, nga te cilat 7 raste per mase me te rende sigurimi “Arrest ne burg” dhe 1 rast per mase me te bute sigurimi. Ne 2 raste jane pranuar nga Gjykata e Apelit duke u vendosur masa e “Arrestit ne burg”, ne 1 rast eshte pranuar kerkimi i prokurorit duke vendosur mase me te bute sigurimi, ndersa ne 5 raste eshte miratuar vendimi i Gjykates se Shkalles se Pare.

Ne 5 raste eshte hequr dore nga apeli i prokurorit, ku per 3 raste per shkak se ankimi i prokurorit ka qene jashte afatit ligjor 5 ditor te ankimit; ne 1 rast nuk legjitimohet te beje ankim dhe ne 1 rast nuk eshte mbeshtetur apeli i prokurorit, pasi nuk kane ekzistuar kriteret ligjore per caktimin e arrestit ne burg.

Ne 131 raste eshte kerkuar nga prokurori i apelit miratim vendimi te Gjykates se Shkalles se Pare, ku nga Gjykata e Apelit ne 103 raste eshte vendosur me miratim vendimi; ne 27 raste eshte ndryshuar masa e sigurimit “Arrest ne burg” me nje mase sigurimi me te bute, ndersa ne 1 rast eshte shfuqizuar vendimi.

Ne gjykimet me kete objekt, Prokuroria e Apelit Korçe orientohet ne zbatimin me korrektesi jo vetem te nenit 228 e 229 te K.Pr.Penale, por sidomos te kerkesave te nenit 230 te K.Pr.Penale, lidhur me kriteret e veçanta te “Arrestit ne burg”. Megjithate duhet te tregohet kujdes ne aplikimin e kesaj mase sigurimi. Krahës llojeve te tjera te masave te sigurimit ne veçanti konstatohet zbatimi i mases se sigurimit “garanci pasurore” nga gjykata. Garancia pasurore sipas nenit 236/1 i K.Pr.Penale, e kushtezon zevendesimin e mases arrest ne burg ose ne shtepi kur eshte vendosur vetem per shkak te ekzistences se rrezikut te ikjes. Gjithsesi kostatohen raste abuzive nga Gjykata e Apelit, pasi ka zevendesuar

arrestin ne burg me garanci pasurore edhe pse kane ekzistuar shkaqe te tjera te rendesishme qe vene ne rrezik marrjen ose vertetesine e provave, apo rreziku i perseritjes se vepres penale. Ketu permend rastet ndaj personave nen hetim Petrit Kupe dhe Çlirim Hoxha, hetuar per vepren penale te shkeljeve te rregullave te qarkullimit rrugor me pasoja vdekje, ku ne keto raste eshte ushtruar rekurs per shkelje te ligjit.

Ne zbatim te Kodit te Drejtesise Penale per te Mitur dhe siç rekomandon Keshilli i Ministrave, **kerkesa per masen e sigurimit "Arrest ne burg" per te miturit, te jete rast perjashtimor dhe ne rastet kur ajo kerkohet/vendoset, duhet qe hetimet te perfundojne ne kohen me shkurter te mundshme; Ashpersim te mases se sigurimit/denimit ndaj personave me rrezikshmeri te madhe shoqerore dhe per vepra penale qe parashikojne mase denimi ne minimum mbi 5 vjet burgim;**

Ne kete kontekst, ne kerkimet per masen e sigurimit "Arrest ne burg", prokuroria duhet te jete e kujdesshme, sepse kjo mase nuk mund te behet pafund prioritare ne raport me masat e tjera te sigurimit edhe per vepra te lehta.

Per vitin 2018 Prokuroria e Apelit Korçe ka ekzekutuar 46 Urdhera ekzekutimi te vendimeve penale, te urdheruara menjehere nga Gjykata e Apelit.

Nga Prokuroria e Apelit Korçe, jane ushtruar 51 rekurse qe lidhen me pafajesi, ndryshim kualifikimi, mase denimi apo masa sigurimi.

Nga ana e prokurorise, per natyren e veprimtarise se saj, ka nje bashkepunim korrekt me Prokurorite prane Gjykates se Shkalles se Pare dhe Policine Gjyqesore. Ky bashkepunim eshte i domosdoshem per nje zgjidhje te drejte dhe ligjore gjate gjykimit te çështjes ne Gjykatën e Apelit. Kjo kushtezon nje komunikim permanent ne marrjen e akteve te ndryshme, fashikullit te prokurorit, marrjen e provave shtese kur çelet shqyrtimi gjyqesor, apo edhe per fazen e ekzekutimit. Ne çdo moment, Prokuroria e Apelit Korçe ve ne dijeni Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare (prokurorin e çështjes) per menyren e perfundimit te çështjeve, sidomos ato te ndjekura mbi apelin e prokurorit. Mbarevajtja e veprimtarise se Prokurorise se Apelit Korçe lidhet edhe me nje bashkepunim te mire me Gjykatën e Apelit.

Ne Prokurorine e Apelit Korçe, gjate vitit 2018 jane permbushur te gjitha shpenzimet e parapercaktuara ne projekt-buxhetin e vitit 2018, qe perfshijne zerat: paga, sigurime shoqerore dhe shpenzimet operative.

- Disa prej objektivave ne zbatim te buxhetit per Prokurorine e Apelit Korçe jane:
 - Menaxhimi me efektivitet, eficence dhe garantimi i zbatimit te ligjit, ne drejtim te perdorimit te fondeve buxhetore qe miratohen per Prokurorine

e Apelit Korçe, ne mbeshtetje te aktivitetit te institucionit per realizimin e misionit te tij.

-Ndjekja e hapave dhe procedurave per administrimin efektiv te fondeve buxhetore, nepermjet analizes dhe nderrmarrjes se veprimeve qe garantojne realizimin e buxhetit te akorduar per Prokurorine e Apelit.

-Implementimin e kuadrit ligjor per menaxhimin financiar dhe kontrollin me fokus kryesor ndergjegjesimin e te gjithe punonjesve te institucionit mbi rritjen e efikasitetit te perdorimit te burimeve financiare dhe zbatimi i ligjshmerise ne drejtim te perdorimit te fondeve te akorduara.

-Ofrimi i nje pune cilesore ne funksion te zbatimit te ligjit dhe mbrojtjes se interesave publike dhe te lirive dhe te te drejtave te njeriut.

-Permiresimi i sherbimeve per punonjesit e prokurorise dhe maredhenieve me te tretet.

- Korrektesia dhe disiplina financiare kane qene ne nivel shume te larte ne menyren e administrimit sa me eficient te shpenzimeve. Konstatohet bashkepunim efektiv me Drejtorine Ekonomike prane Prokurorise se Pergjithshme.
- Disiplina ne pune shihet si nje element qe ndikon ne veprimtarine e Prokurorise se Apelit Korçe, e cila respektohet nga te gjithe punonjesit.
- Po keshtu, Kodi i Etikes dhe rregullat e vendosura prej tij, jane ne vemendje te prokuroreve dhe punonjesve te tjere te Prokurorise dhe respektohen maksimalisht.

Faleminderit!

**PROKURORE E APELIT
ROZETA QIRJAQI**